P-70202040-00431-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Dumnicë E Llugës / Dumnicë E Llugës / Dumnicë E Llugës	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shqetore Društvena Imovina Socially owned Land /	DERMENCE / DERMENCE / DERMENCE	101525	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 4 (101525 m²) / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 4 Klase / / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202041-00846-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Mihaliq / Mihaliq / Mihaliq	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shqetore Društvena Imovina Socially owned Land /	GELJE / GELJE / GELJE	23453	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 4 (11501 m²) / Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 5 (11952 m²) / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 4 Klase / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 5 Klase / / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202044-00586-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Novolan / Novolan / Novolan	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shqetore Društvena Imovina Socially owned Land /	KUQERINE/VETER NIK / KUQERINE/VETER NIK / KUQERINE/VETER NIK	25832	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 (25832 m²) / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	


P-70202044-01096-0	VUSHTRRI / VUCITRN / VUSHTRI	Novolan / Novolan / Novolan	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna Imovina Privately owned Land / R		TOMOVO BRDO/G.LIVADHE / TOMOVO BRDO/G.LIVADHE / TOMOVO BRDO/G.LIVADHE	2100	Bujqësore - Arat - Atë E Klasës 4 (2100 m ²) / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 4 Klase / / Agriculture - Arable - 4th Class Arable Land / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	05.06.2020
P-70202047-00343-0	VUSHTRRI / VUCITRN / VUSHTRI	Akrashicë / Akrashicë / Akrashicë	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		BRDSKA STRANA / BRDSKA STRANA / BRDSKA STRANA	87873	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 5 (87873 m ²) / / Poljoprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 5 Klase / / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202050-00912-0	VUSHTRRI / VUCITRN / VUSHTRI	Pasomë / Pasomë / Pasomë	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		LEDINA XHUKES / LEDINA XHUKES / LEDINA XHUKES	39631	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 4 (39631 m ²) / / Poljoprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202053-00366-1	VUSHTRRI / VUCITRN / VUSHTRI	Prelluzhë / Prelluzhë / Prelluzhë	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		SELISHTA / SELISHTA / SELISHTA	25436	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 2 (25436 m ²) / / Poljoprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 2 Klase / / Agriculture - pasture - 2nd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202053-00573-1	VUSHTRRI / VUCITRN / VUSHTRI	Prelluzhë / Prelluzhë / Prelluzhë	PARCELE / PARCELA / parcel	/ R		SELISHTA / SELISHTA / SELISHTA	28012	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 2 (28012 m ²) / / Poljoprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 2 Klase / / Agriculture - pasture - 2nd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	

P-70202053-00573-2	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Prellužhë / Prellužhë / Prellužhë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		SELISHTE / SELISHTE / SELISHTE	5140	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 1 (5140 m²) / / Poljopritredno - Pashnjaci - Pashnjak 1 Klase / / Agriculture - pasture - 1st Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dizavina / Single possessor	
P-70202053-00582-1	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Prellužhë / Prellužhë / Prellužhë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		SELISHTE / SELISHTE / SELISHTE	24563	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 2 (24563 m²) / / Poljopritredno - Pashnjaci - Pashnjak 2 Klase / / Agriculture - pasture - 2nd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dizavina / Single possessor	
P-70202054-00392-1	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Reznik / Reznik / Reznik	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		ZHARUÇARDAK / ZHARUÇARDAK / ZHARUÇARDAK	120796	Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 6 (120796 m²) / / Poljopritredno - Njive - Njiva 6 Klase / / Agriculture - Arable - 6th Class Arable Land / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dizavina / Single possessor	

P-70202061-00079K-2	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Sllatinë / Sllatinë / Sllatinë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna Imovina Privately owned Land / R	T-5 / T-5 / T-5	14126	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 2 (339 m²) / Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 3 (713 m²) / Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 4 (1569 m²) / Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 5 (8038 m²) / Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 8 (3267 m²) / / Poljoiprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 2 Klase / Poljoiprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 3 Klase / Poljoiprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / Poljoiprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 5 Klase / Poljoiprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 8 Klase / / Agriculture - pasture - 2nd Class Pasture / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / Agriculture - pasture - 8th Class Pasture / /	1 / 1	Poseidim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	10.11.2020
P-70202061-00465-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Sllatinë / Sllatinë / Sllatinë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shogëtorë Drushivena Imovina Socially owned Land /	LAZ/CIGANSKI BREG / LAZ/CIGANSKI BREG / LAZ/CIGANSKI BREG	5915	Bujqësore - Kulllosat - Kulllosë E Klasës 4 (5915 m²) / / Poljoiprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 4 Klase / / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Poseidim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	

P-70202062-00106K-1	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Qytezë / Qytezë / Qytezë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë private Privatna Imovina Privately owned Land / R	T-42 / T-42 / T-42	1002	Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 8 (1002 m ²) / Poljoprivredno - Njive - Njiva 8 Klase / Agriculture - Arable - 8th Class Arable Land / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	23.12.2019
P-70202063-00037-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Strovc / Strovc / Strovc	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /	ROPÇA/VRCAK / ROPÇA/VRCAK / ROPÇA/VRCAK	54774	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 5 (54774 m ²) / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashjak 5 Klase / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202064-00045-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Taraxhë / Taraxhë / Taraxhë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /	KOVAÇEVIQ/BRE G / KOVAÇEVIQ/BRE G / KOVAÇEVIQ/BRE G	48418	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 4 (48418 m ²) / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashjak 4 Klase / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202068-00897-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Ceceli / Ceceli / Ceceli	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / U	SHORTA / SHORTA / SHORTA	50538	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 6 (50538 m ²) / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashjak 6 Klase / Agriculture - pasture - 6th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202068-00945-0	VUSHTRI / VUCITRN / VUSHTRI	Ceceli / Ceceli / Ceceli	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / U	SHORTA / SHORTA / SHORTA	27555	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 7 (27555 m ²) / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashjak 7 Klase / Agriculture - pasture - 7th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	

P-70202068-00995-0	VUSHTTRI / VUCITRI / VUSHTTRI	Ceceli / Ceceli / Ceceli	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land / R		FUSHA / FUSHA / FUSHA	11698	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 7 (11698 m ²) / / Poljoprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 7 Klase / / Agriculture - pasture - 7th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dizavina / Single possessor	
P-70202071-00461-0	VUSHTTRI / VUCITRI / VUSHTTRI	Shitiricë / Shitiricë / Shitiricë	PARCELË / PARCELA / parcel	Pronë shoqërore Društvena Imovina Socially owned Land /		CRNI LUG/CRKVENI BREG / CRNI LUG/CRKVENI BREG / CRNI LUG/CRKVENI BREG	11379	Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 (11379 m ²) / / Poljoprivredno - Pashnjaci - Pashnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dizavina / Single possessor	
Totali i sipërfaqes sé parcelave: 4439342											





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202044-00529-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	18-5325/25
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	17.12.2025 - 11:21
Komuna / Opština / Municipality:	VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Novolan / Novolan / Novolan
Zyrtar Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70202044-00529-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		15761			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
KUQERINE/VETERNIK				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina Area
1	Bujgësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashnjaci/pasture	Kulllosë E Klasës 3/Pashnjak 3 Klasse/3rd Class Pasture	15761

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Vushtrrisë	600535001	VUSHTRRI / VUSHTRRI		AHMET KRASNIQI	1/1		




KOMUNA E VUSHTRISË

FLETËTREGUES (I gjendjes faktike ne komasacion)

Zona Kadastrale Qytezë

[illegible]

Gjeodeti





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Datë: 23.12.2025

PËR:	Kuvendin e Komunës
NGA:	Melihate Basholli - Latifi  Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
TEMA:	Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026

Të nderuar/a,

Bashkëngjitur keni Draft-Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026, të cilin e ka hartuar kryesuesja e kuvendit në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Presim që në mbledhjen e kuvendit të jepen propozime të reja nga anëtarët e kuvendit, ashtu që të hartojmë një plan sa më gjithëpërfshirës dhe të zbatueshëm që të kemi efektivitet në punën e kuvendit përgjatë vitit 2026.

I propozojmë Kuvendit të Komunës që ta aprovojë këtë dokument.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI

**DRAFT-PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË PËR
VITIN 2026**

Dhjetor, 2025

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Qëllimi.....	5
Janar.....	6
Shkurt.....	7
Mars	8
Prill	9
Maj	10
Qershor	11
Korrik.....	12
Gusht	13
Shtator.....	14
Tetor	15
Nëntor.....	16
Dhjetor	17

HYRJE

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët, si dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Statutit të Komunës dhe akteve tjera nënligjore.

Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe rregulloren e punës, rregulloret komunale, miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës;
- planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- themelimin e komisioneve të kërkuara sipas këtij ligji;
- zgjedhjen e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komunës;
- nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike;
- arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brendakomunale;
- marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës;
- përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij Komitetit për Politikë dhe Financa apo Kryetarit të komunës. Kuvendi i komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, Planin vjetor të prokurimit, Rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, Planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.

Kuvendi i komunës siguron kushte të punës për mbajtje të mbledhjeve të Kuvendit të komunës, krijon hapësirë për pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë mbledhjeve, siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i komunës kryen edhe aktivitete tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së tij, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
- Miratimin e Planeve Strategjike të Zhvillimit Ekonomik Lokal, etj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren për Punën e Kuvendit dhe Organeve të Tij dhe akteve tjera nënligjore. Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapa të realizimit të punëve dhe detyrave të kuvendit, të bazuara në përgjegjësitë që dalin nga legjislacioni në fuqi.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2026, ku Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë planifikon t'i mbajë dhjetë (10) mbledhje të rregullta, gjashtë prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, në të cilat do të trajtohen çështjet që janë në interes të komunës dhe të qytetarëve të saj. Përveç tjerash, Kuvendi i komunës trajton edhe këto çështje:

- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit;
- Miraton çështjet tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas statutit apo rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese, sipas ligjeve në fuqi;
- Themelon komitetet këshillëdhënëse dhe trupa tjera ad-hoc sipas nevojës;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të komunës sipas ligjit;
- Organizon takime buxhetore me qytetarë, lidhur me planifikimin e buxhetit të komunës;
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit komunal.

QËLLIMI

Plani vjetor i punës i Kuvendit të komunës ka për qëllim që t'i ndihmojë dhe lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke ju ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, në ç'rast ata do ta kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2026, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me këtë plan janë paraparë dhjetë (10) mbledhje të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe mbledhje të tjera, përfshirë mbledhjet e jashtëzakonshme, urgjente, solemne, siç parashihen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Udhëzimin Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Dinamika e Planit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë do të realizohet në bazë të orarit të mbledhjeve të Kuvendit, të miratuara në mbledhjen e parë të Kuvendit në vitin 2026.

Kryesuesja e Kuvendit mund të mbajë takime mujore ose sipas nevojës me shefat e grupeve kuvendare të subjekteve politike të përfaqësuara në kuvend, me qëllim të bashkërendimit të punës së Kuvendit.

Për përmbushjen e planit të punës, ekzekutivi ju ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës, sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve sipas dinamikës, të përcaktuara me këtë plan do të përkujdesen: Kryetari i komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.

Realizimi i Planit të Punës të Kuvendit, kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me ekzekutivin e komunës, i cili duhet t'i përmbahet Planit të Kuvendit për vitin 2026.

Plani i Punës i Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga Kuvendi.

**PLANI
I PUNËS I KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË PËR VITIN 2026**

JANAR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport vjetor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2025	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	5.1.2026
2.	Draft – Rregullore për Transparencë në Komunën e Vushtrrisë 2026-2029;	Zyra për Informim		5.1.2026
3.	Draft – Plani i veprimit për transparencë komunale 2026-2029;	Zyra për Informim		5.1.2026
4.	Të ndryshme			5.1.2026

SHKURT

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë për shërbimet shëndetësore për vitin 2025 në Komunën e Vushtrisë	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale		3.2.2026
2.	Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrisë për vitin 2025	Komandanti i stacionit policor në Vushtrri		3.2.2026
3.	Informatë lidhur me procedurën e kërkesave për lejet ndërtimore për vitin 2025	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		3.2.2026
4.	Të ndryshme			3.2.2026

MARS

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2025	Kryetari i komunës		3.3.2026
2.	Informatë për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2025/2026	Drejtoria për Arsim		3.3.2026
3.	Raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm	Drejtoria për Buxhet dhe Financa (ZKF)		3.3.2026
4.	Informatë lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025	Drejtoria për Inspektive		3.3.2026
5.	Informatë lidhur me ofrimin e shërbimeve nga Drejtoria për Administratë për vitin 2025	Drejtoria për Administratë		3.3.2026
6.	Raport për punën e NPL “Përparimi” në Vushtrri për vitin 2025	Komisioni i aksionarëve		3.3.2026
7.	Të ndryshme			3.3.2026

PRILL

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2.4.2026
2.	Informatë e punës së Ndërmarrjes regjionale ujësjellësi “Mitrovica” për vitin 2025	Drejtoria për Shërbime Publike		2.4.2026
3.	Shqyrtimi i Planit të veprimit për të gjeturat e auditorit të përgjithshëm	Drejtoria për Buxhet dhe Financa (ZKF)		2.4.2026
4.	Të ndryshme			2.4.2026

MAJ

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Propozim- vendim për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për Ditën e Çlirimit, për vitin 2026	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	Komisioni për ndarjen e mirënjohjeve dhe dekoratave	2.5.2026
2.	Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.5.2026
3.	Informatë lidhur me Qarkoren buxhetore 2027 dhe miratimi i Planit të veprimit për dëgjimet publike	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.5.2026
4.	Të ndryshme			2.5.2026

QERSHOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Draft - Korniza Afatmesme (KAB) për vitet 2027-2029	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.6.2026
2.	Informatë rreth procedurës së legalizimit të objekteve pa leje për vitin 2025	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		2.6.2026
3.	Të ndryshme			2.6.2026

KORRIK

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të komunës, për periudhën janar-qershor 2026	Kryetari i komunës		3.7.2026
2.	Raport gjashtëmuor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.7.2026
3.	Pasqyrat financiare për vitin 2025 dhe raporti i auditorit të përgjithshëm	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	3.7.2026
4.	Informatë për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2025/2026	Drejtoria për Arsime		3.7.2026
5.	Informatë lidhur me mbrojtjen e mjedisit janar-qershor 2026	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		3.7.2026
6.	Të ndryshme			3.7.2026

GUSHT

MUAJ I PUSHIMEVE

SHTATOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Shqyrtimi i draft- buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2027	Kryetari i komunës		2.9.2026
2.	Raporti i sistemit për matjen e performancës në ofrimin e shërbimeve komunale për vitin 2025	Koordinatori për performancë i Komunës së Vushtrrisë		2.9.2026
3.	Raport për situatën ekonomiko - financiare dhe zbatimin e planeve investuese, për periudhën janar-qershor 2026	Kryetari i komunës		2.9.2026
4.	Informatë për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore për vitin 2026	Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural		2.9.2026
5.	Raport lidhur me progresin në zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm	Drejtorja për Buxhet dhe Financa (ZKF)		2.9.2026
6.	Të ndryshme			2.9.2026

TETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Raport nëntëmujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për vitin 2026	Kryetari i komunës	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	2.10.2026
2.	Informatë nëntëmujore për punën e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport		2.10.2026
3.	Informatë për furnizimin me ujë të pijes në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		2.10.2026
4.	Propozim – vendim për formim të komisionit për hartimin e Draft - Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2026	Kryesuesja e Kuvendit		2.10.2026
5.	Të ndryshme			2.10.2026

NËNTOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Informatë për punën e Drejtorisë për Ekonomi dhe Investime Kapitale janar-shtator 2026	Drejtoria për Ekonomi, dhe Investime Kapitale		2.11.2026
2.	Propozim - Vendim për caktimin e normave tatimore për vitin 2027	Drejtoria për Buxhet dhe Financa		2.11.2026
3.	Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2025/2026 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2026/2027	Drejtoria për Arsime		2.11.2026
4.	Informatë lidhur me zbatimin e Planit zhvillimor komunal	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit		2.11.2026
5.	Informatë për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Vushtrrisë	Drejtoria për Shërbime Publike		2.11.2026
6.	Informatë lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore janar-shtator 2026	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë		2.11.2026
7.	Të ndryshme			2.11.2026

DHJETOR

Nr.	AKTIVITETET	ORGANI PËRGJEGJËS		AFATI I PROCEDIMIT
1.	Draft-Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2027	Kryesuesja e Kuvendit		03.12.2026
2.	Draft-Plani i punës i Kryetarit të komunës për vitin 2027	Kryetari i Komunës		03.12.2026
3.	Propozim-vendim për publikimin e listës së pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim për vitin 2027 në Komunën e Vushtrrisë	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë		03.12.2026
4.	Informatë për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-nëntor 2026	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – Qendra për Punën Sociale		03.12.2026
5.	Të ndryshme			03.12.2026

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



P L A N I

I PUNËS I KRYETARIT – QEVERISË KOMUNALE PËR VITIN 2026

Dhjetor 2025

PLANI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2026

Hyrtje

Kryetari i komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij bazuar në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, ligjeve dhe akteve nënligjore, që janë me interes për komunën dhe qytetarët. Këto kompetenca dhe përgjegjësi realizohen po ashtu edhe në bazë të planit të tij të punës, i cili është dokument bazë për punën njëvjeçare të kryetarit të komunës, përkatësisht qeverisë komunale.

Në Planin e punës së Kryetarit të komunës përkatësisht qeverisë komunale janë paraqitur prioritetet, objektivat, aktivitetet e planifikuara, si dhe afatet për realizimin e tyre. Ky plan natyrisht që gjatë vitit 2026 do të mund të plotësohet varësisht prej nevojave dhe mundësive buxhetore.

Përmes këtij plani ne do të mund të kanalizojmë nismat për planifikim të prioriteteve, të cilat do të mund të realizohen bazuar në planifikimin buxhetor të vitit 2026 për realizim të projekteve kapitale të cilat i kemi planifikuar në këtë vit për t'i realizuar në vitin që po hyjmë për të përmirësuar cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë. Gjatë përbushjes së objektivave sigurisht që ka sfida sidomos me mjetet buxhetore të cilat realisht mund të na merren nga gjykatat si pasojë e kontratës kolektive në arsim dhe shëndetësi siç ka ndodhur gjatë viteve të fundit.

Prioritetet kryesore gjatë vitit 2026:

- Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës;
- Angazhimet e vazhdueshme për realizimin e të hyrave të planifikuara buxhetore dhe shfrytëzimi sa më racional i mjeteve buxhetore, përkatësisht shpenzimeve buxhetore;
- Raportimi i rregullt në Kuvendin e Komunës;
- Angazhim i vazhdueshëm për shpenzim maksimal të mjeteve financiare të investimeve kapitale, sidomos mjeteve të grantit qeveritar;
- Vazhdimi i projektit për furnizim me ujë të pijes në të gjitha vendbanimet e komunës ku është i shtrirë rrjeti primar dhe sekondar si dhe ndërtimi i rrjetit në të gjitha vendbanimet;
- Ndërtimi i kolektorit kryesor në Sfaracak Nedakoc-Studime, Pasomë, Bajskë, Sllatinë Samadrexhë, Akrashiticë, Maxhunaj si dhe kanalizimeve në fshatra, (vazhdim nga viti i kaluar);
- Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse aty ku do të jetë e nevojshme;
- Ndërtimi i rezervuarit të ujit për furnizim të fshatrave në pjesën lindore;
- Ndërtimi i stacionit të autobusëve në qytet;

- Ndërtimi i tregut të qytetit;
- Rregullimi i parqeve ekzistuese dhe ndërtimi i parqeve te reja;
- Zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik;
- Shfrytëzimi sa më racional i pronave (tokave dhe objekteve) në pronësi të komunës përmes dhënies në shfrytëzim;
- Mblidhja e implementimit të kontratave për pronat e komunës që janë dhënë në shfrytëzim (tokave dhe objekteve);
- Ndërmarrja e masave për lirimin e pronave komunale të uzurpuara;
- Angazhimet për gjetjen e donatorëve për investime kapitale në komunë e në veçanti në sektorin e bujqësisë;
- Rritja e prodhimit të bujqësore, përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve, organizimi i trajnimeve dhe keshillimeve profesionale për fermerë, si dhe subvencionimi i tyre;
- Vazhdimi i subvencionimit të ujërës së tokave e bujqve;
- Angazhimet për kthimin në pronësi të komunës të parcelave që më herët iu ishin dhënë në shfrytëzim Burgut të Smrekonicës, të cilat tani evidentohen në emër të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të themelimit të zonës së lirë ekonomike në fsh. Banjskë dhe Smrekonicë;
- Ofrimi i shërbimeve administrative sa më cilësorë ndaj qytetarëve;
- Gjithëpërfshirja në arsim dhe ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- Avancimi i aktiviteteve kulturore atyre të rinisë dhe në lëmin e sportit;
- Ofrimi i mbështetjes së klubeve sportive, organizatave të dala nga lufta, organizatave rinore, OJQ –ve tjera të komunës, si dhe kategorive tjera;
- Bashkëpunimi me organet e nivelit qendror, veçanërisht me qeverinë dhe ministrinë e linjës për bashkëfinancim të projekteve që janë me interes për komunën dhe qytetarët;
- Bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe qytetarë, duke krijuar mundësitë për pjesëmarrje sa më të madhe të tyre në proceset e vendimmarrjes në komunë;
- Mbështetja e Ndërmarrjes Publike Komunale “Përparimi”;
- Rregullimi i memorialëve;
- Zgjerimi i rrjetëve të vendosjes së kamerave në qytet dhe shkollat;
- Angazhime tjera për çështje me rëndësi dhe interes për qytetarët për mirëqenie dhe jetë më të mirë të tyre.

Planifikimet sipas drejtorive

Buxheti dhe Financat

Nr.	Drejtoria	Objektivat	Aktivitetet	Afati	Ecuri	Pjesëmarrësit tjerë	Ndërlidhja me
1	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	1 .Hapja e viti fiscal dhe përgatitjet për startimin e sistemit të pagesave (Free Balanc) për vitin fiskal 2026.	1.Kompletimi i dokumentacionit për të gjitha programet buxhetore dhe monitorimi i tyre	1. Janar/2026		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive	Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
		2.Rregullimin e dokumentacionit për personat me autorizimet e veçanta personat: nëpunësi administrativ i pagesave, personi autorizues, personi aprovues, personi zotues dhe certifikuesi për periudhën 2026.	2.Plotsimi i kërkesës për qasje të përdoruesve në SIMFK.	2. Janar/2026	Sipas planit të trijedhës së parasë së gatshme		Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
2		3.Pasqyrat financiare për buxhetit për vitin 2025	3.Plotsimi më efikas dhe dorëzimi i PVF	3. Janar/2026			
3							

4		4.Përgatitja e trijedhës së parësë për të gjitha programet për vitin 2026	4.Plotsimi i formularëve të trijedhës së parësë në bazë të planifikimit të buxhetit në MEF.	4. Janar/2026			
5		5.Baritja e të hyrave vetanake të tejkaluara të paslpenzuara nga viti 2025	5.Implementimi i të hyrave të bartura në vitin 2025	5. Shkurt-Mars/2026			
6		6.Përgatitja e Raporteve tremujore për vitin 2026	6.Implementimi i raporteve ne Kuvend dhe Ministri	6.Qdo tre muaj			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
7		7.Përgatitjet e duhura për realizimin e projekteve të pa kryera nga viti 2025 (projektet investuese).	7.Kompletimi i dokumentacionit për zotimin e mjeteve	7. Shkurt-Mars/2026			
8		8.Barazimi mujor i shpenzimeve në sistemin FB	8.Përmbaritja e afatit kohor në bazë të Udhëzimit administrativ 02/2010	8. Çdo muaj/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive

		9. Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave vetanake për tremujorin e parë.	9. Përgaditja e informatës lidhur me realizimin e buxhetit dhe inkasimin e të hyrave për të gjitha programet buxhetor	9. Çdo tre muaj/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
9		10. Prezantimi i Qarkores 01/2027 kufijve të par buxhetor dhe përpunimi i buxhetit për vitin 2027-2029 konform qarkoreve nga MEF-i	10. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventua të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2026	10. Maj-Qershor/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
10		11. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventua të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2025	11. Të harmonizoj kërkesat e drejtorive për ndryshimin eventua të buxhetit të rishikuar për vitin fiskal 2025	11. Qershor/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
11		12. Përgatitjet për rishikimin buxhetor (varësisht nga kërkesat e MEF-it)	12. Përgaditja e formularëve lidhur ndryshimet buxhetore	12. Qeshor-Korrik/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
12							

		13.Përcjellja e realizimit të shpenzimeve buxhetore të mjeteve sipas dinamikës së paraparë për gjashëmujorin e parë për vitin fiskal 2026	13.Raportimi informates lidhur me projektet e realizuara në bazë të planifikimit të buxhetit	13. Qershor/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
13		14.Informatë për realizimin e investimeve kapitale, realizimi i projekteve të parapara me planin dinamik të shpenzimeve.	14.Përgaditja e informatë lidhur me shpenzimet buxhetore	14. Korrik/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
14		16.Përgatitja e tregueseve final buxhetor për vitin 2026 konform qarkores nga MEF-i	16.Evidentimi i të gjitha kërkesave te drejtorive për vitin fiskal 2027.	16. Shtator/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
15		17.Përgatitjet për përmbylljen e vitit fiskal buxhetor 2026		17. Dhjetor/2026			Të gjitha programet buxhetore të drejtorive
16							

Ekonomi

Nr.	Prioritet et	Aktivitetet e planifikuara	Koha e implementimit	Buxheti €	Akterët implementues të projektit	
1	Hartimi i raporteve për drejtorinë e EIK	Hartimi i raportit të punës për vitin 2025	dhjetor2025 janar 2026	-	Drejtoria e EIK	
2	Vizita biznesese Organizimi i panaireve per produktet vendore	Vizita mujore Korrik	Janar-dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e EIK	
3	Përgatitja e projekteve-para masave.	Hartimi i propozim projekteve-pa masave, shpalljeve me të gjitha aktet përcjellëse	Qershor	-	Drejtoria e EIK	
4	Shërbime e ofruara per biznese ne kuadër te ARBK – se	Përpunimi i të dhënave në formë elektronike për regjistrim dhe ndryshimeve tjera të bizneseve sipas programeve. Formulimi i dosjeve për regjistrim ,shuarje,ndryshim,llogo,leje pune etj.	Janar-dhjetor	-	Drejtoria e EIK	
5	Hartimi i raporteve ne kuadër te drejtorisë dhe MTT –se	Përcielija e Intranetit për mënyrën e zgjedhjes së lëndëve të drejtorisë. Pregaditja e raporteve ,tre mujore dhe vjetore për drejtorinë. Pregaditja e raportit financiar për ARBK.	Janar – dhjetor		Drejtoria e EIK	

6	Bashkëpunimi me Organizatat Nderkombetare, Banka kombetare per Zhvillim, USAID – Thithja e investimeve direkte	Bashkëpunimi me Organizatat Nderkombetare si dhe thithja e investimeve nga jashtë	Janar-dhjetor		Drejtorja e EIK
---	--	---	---------------	--	-----------------

Administratë

Rezultati 1. Kushte optimale për pune dhe sistemet funksionale							
Objektivi	Aktivitetet	Treguesit	Afati - kohor	Kostoja financiare	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Komentet
Mirëmbajtja e objektit te komunës dhe sistemeve te saja	1. Inicimi i procedurave për Mirëmbajtjen e gjeneratorit	Kontratat te nënshkruara	Shkurt	2000,00	Buxheti i komunës	Drejtoria për administrate Drejtoria për prokurim	
	2. Inicimi i procedurave për Mirëmbajtjen e e-Kioskut		Mars	3500,00			
	3. Mirëmbajtja e sistemit te radhës		Mars	7500,00			
	4. Furnizim me kartiga		Mars mars	3000,00 12000,00			
	5. Furnizim me pajisje te TI						
	6. Furnizim me veshmbathje		Prill	4000,00			

Rezultati 1. Kushte me te mira te punës						
Objektivi	Aktivitetet	Treguesit	Afati -kohor	Kostoja financiare	Burimi i financimit	Përgjegjësia
Ridizajinimi dhe rregullimi i sallës së kurorëzimeve	Inicimi i procedurave te prokurimit	Kontrata e nënshkruar për ndërtim	Maj	7500,00	Buxheti i komunës	Njësia kërkuese dhe D. për prokurim

Rezultati 1.						
Objektivi	Aktivitetet	Treguesit	Afati -kohor	Kostoja financiare	Burimi i financimit	Përgjegjësia
Pëmbushja e obligimeve ligjore ne fushën e mbrojtjes se te drejtave te njeriut, femijëve, barazisë gjinore dhe mundësive te barabarta	Hartimi i Rregullores Komunale për Funksionimin e Asamblese së Femijëve	Dokumenti i hartuar	Mars	100.00	Buxheti i komunës	Njësia DKA

Sektor i për gjendje civile

Rezultati 1. Përmirësimi i cilësisë dhe minimizimi i kohës së pritjes gjatë ofrimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët.						
Objektivi 1	Aktivitetet	Treguesit	Afati -kohor	Kostoja financiare	Burimi i financimit	Përgjegjësia

1. Shërbime efikase dhe të shpejta për qytetarët me fokus në ngritjen e cilësisë dhe efektivitetit gjatë procesimit dhe trajtimit të kërkesave.	1.1.1. Informimi i shpejtë dhe i saktë, me shkrim dhe verbal 1.1.2. Informimi dhe ndihma për qytetarë gjatë përdorimit të sistemit elektronik E-Kosova, me rastin e aplikimit dhe marrjes së shërbimeve online. 1.1.2. Komunikimi korrekt i zyrtarit me qytetar gjatë dhënies së informacioneve dhe ofrimit të shërbimeve, duke respektuar kodin e etikës. 1.1.3. Ngritja e efektivitetit dhe transparenca gjatë kompletimit të dosjes për fitim dhe humbje të shtetësisë dhe dërgimi në DSHAM në rrugë zyrtare, 1.1.4. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit gjatë trajtimit të kërkesave për korrigjimin dhe ndërrimin e të dhënave personale të qytetarit. 1.1.5. Ngritja e efikasitetit gjatë trajtimit të kërkesave për lajmërimin dhe ndërrimin e adresës së vendbanimit 1.1.6. Sigurimi që të dhënat personale të komunikohen vetëm personit për të cilën mbahen shënimet dhe	1.1.1. Numri i certifikatave të lëshuara të lëshuara 1.1..3. numri i kërkesave të procesuara për fitim dhe humbje të shtetësisë. 1.1.4. numri i vendimeve të nxjerra. 1.1.5. numri i lëndëve të kryera.	Janar-dhjetor	€		Zyra e Gjendjes civile dhe drejtoria për administratë
--	---	--	----------------------	----------	--	--

Rezultati 2. Lehtësimi dhe thjeshtëzimi i procedurave për deklarimin dhe regjistrimin e fakteve të lindjeve dhe të vdekjeve me qëllim të minimizimit dhe parandalimit të rasteve të pa deklaruara dhe të pa regjistruara.

Objekti 2	Aktivitetet	Treguesit	Afati - kohor	Kostoja financiare	Burimi i financimit	Përgjegjësia	Komentet
2.1.Përmirësimi dhe thjeshtëzimi i vazhdueshëm i procedurave administrative gjatë regjistrimit të fakteve të gjendjes civile dhe menaxhimi i regjistrave të gjendjes civile në mënyrë të saktë dhe të përditësuar.	2.1.1. Regjistrimi i fakteve të të lindurave, të martuarve dhe të vdekurve në regjistrin themeltar dhe në regjistrin qendror elektronik të gjendjes civile 2.1.2.Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me drejtuesit e spitalit të qytetit, QKMF-ve dhe QMF-ve, gjate raportimit dhe deklarimit te fakteve për lindjet dhe vdekjet te ndodhura ne këto institucione. 2.1.3. Shtypja e akteve dhe regjistrave të veçantë në të cilët pasqyrohen shënimet e sakta të nënshkruara nga zyrtari dhe pala dhe vullosja e tyre. 2.1.4. Kryerja e ceremonisë solenne të kurorëzimeve brenda dhe jashtë selisë se komunës në mënyrë efikase.	2.1.1. Numri i regjistrimeve të fakteve të lindjes 2.1.2. Numri i regjistrimeve të fakteve të vdekjes 2.1.3. Numri i akteve të krijuara. 2.1.4. Numri i kurorëzimeve. 2.1.5. numri i skanimeve	Janar-dhjetor	€		Udhëheqësi i zyrës se gjendjes civile dhe zyrtaret e gjendjes civile	

	2.1.5.Skanimi i të gjitha dokumenteve të krijuara gjatë përpunimit të të dhënave personale të gjendjes civile dhe arkivimi në arkivin fizik dhe elektronik. 2.1.6.Kujdesi dhe ruajtja e librave fizik nga dëmtimi eventual ose shkatërrimi është detyrim i përhershëm ligjor për së cilin zyrtar të gjendjes civile 2.1.7. Mbrojtja e të dhënave personale, ruajtja e fshehtësisë dhe siguria i të gjitha dosjeve në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale për të parandaluar mundësinë e shfrytëzimit të paligjshëm.							
--	---	--	--	--	--	--	--	--

Qendra për shërbim me qytetarë

Rezultati 1. Shërbime më efëciente dhe transparente duke u siguruar që dhënia e shërbimit për qytetar të bëhet në një hapësirë të caktuar.



<i>Objektivi.1</i>	<i>Aktiviteti</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Afati - kohor</i>	<i>Kostoja financiare</i>	<i>Burimi i financimit</i>	<i>Përgjegjësia</i>	<i>Komentet</i>
--------------------	-------------------	------------------	----------------------	---------------------------	----------------------------	---------------------	-----------------

1.1. Përmirësimi i cilësisë dhe rritja e efikasitetit dhe efektivitetit për shërbimet administrative.	1.1.1.Pranimi dhe regjistrimi i kërkesave dhe parashtrësve në sistemin elektronik (Intranetit), duke i gjeneruar numër unik të protokollit sipas kodit të veçantë me numrin përkatës sipas drejtorive dhe njërive organizative që funksionojnë në komunë. 1.1.2.Protokollimi përmes QSHQK-së i të gjitha shkrësive/parashtrësve duke u siguruar që secila drejtori të jetë e lidhur me këtë qendër, 1.1.3.Pranimi i postës dhe përcjellja në mënyrë elektronike dhe fizike tek drejtoritë përkatëse ose të zyrtarit për gjegjë. 1.1.4. Krijimi i broshurave informuese duke iu mundësuar qytetarëve që të kenë akses të lehtë në shërbimet që ofron komuna dhe duke u siguruar që qytetarët jenë të informuar për procedurat, tarifat dhe për afatet kohore. 1.1.5.Informimi dhe ndihma ndaj qytetarëve për përdorimin e sistemit elektronik E-kosova gjatë aplikimit dhe gjatë marrjes së shërbimeve online.	1.1.1. Numri i kërkesave të pranuar dhe administruara 1.1.2.Numri i shkrësive dhe i vendimeve të protokolluara 1.1.3. numri i kërkesave të pranuar nga posta dhe të shpërndara 1.1.4.numri i informacioneve dhe broshurave informuese të publikuara dhe të shpërndara 1.1.6. numri i akteve administrative të protokolluara	Janar-dhjetor	€	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	Udhëheqësi dhe zyrtarët e Qendrës për Shërbim të Qytetarëve	
---	---	---	---------------	---	---	---	--

1.1.6. Protokollimi në shkrimin me numër unik të protokollit hyrës dhe dalës përmes sistemit të intranetit i të gjitha akteve administrative të nxjerra nga organet e komunës.					
1.1.7. Përdorimi dhe respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore në mënyrë të drejtë dhe të saktë duke respektuar procedurat ligjore dhe afatet kohore.					
1.1.8. Sigurimi që të dhënat personale të komunikohen vetëm personit për të cilën mbahen shënimet dhe personave fizik dhe juridik që i parashen ligji.					

► Rezultati 2. Integrimi i platformave elektronike gjatë procedimit të lëndëve dhe arkivimi elektronik(E-arkivi) i tyre.						
Objektivi 2	Aktivitetet	Treguesit	Afati - kohor	Kostoja financiare	Burimi i financimit	Përgjegjësia
2.1. Digitalizimi i shërbimeve.	2.1.1.Përcjellja përmes sistemit elektronik(intranetit) e të gjitha lëndëve tek drejtoritë përkatëse ose te zyrtarët përgjegjës dhe përfundimi i lëndës në Intranet duke i dhënë përgjigje përfundimtare.	2.1.1. Numri I lendeve fizike dhe elektronike te procesuara	Janar-dhjetor			Të gjitha drejtoritë/njësitë e komunës dhe Qendra për Shërbim të Qytetarëve
1.12. Përkujtimi i demonstratës së studentëve më 1 tetor 1997	1.12.1. Tryezë diskutimi		1 tetor 2026		Komuna Vushtri	DKRS dhe DKA	
1.13. Dita e Pavarësisë së Shqipërisë	1.13.1. Akademi përkujtimore		28 nëntor 2026		Komuna Vushtri	DKRS dhe Shogatat e dala nga lufta e UÇK-së.	

Rezultati 2. Aktivitetet me karakter kulturor, rinor dhe sportiv në Komunën e Vushtrisë, duke përfshirë edhe diët ndërkomëtare							
Objekti	Aktivitetet	Treguesit	Afati -kohor	Kostoja financiare	Burimi i financimit	Përgjegjësia	

2.1. Shënimi Ditës së Mësuesit	2.1.1. Akademi Solenne për Ditën e Mësuesit	7 mars 2026	1,000.00 €	Komuna Vushtri	DKA DKRS	
2.2. Dita Ndërkombëtare e Gruas	2.2.1. Prije e disa grave nga kryetari i komunës 2.2.2. Aktivitetet kulturor, rinor e sportiv me femrat	8 mars 2026	500.00 € 500.00 €	Komuna Vushtri	DKRS DKA	
2.3. Dita e Bibliotekës	2.3.1. Ekspozitë me libra 2.3.2. Tryezë për rëndësinë e librit	24 mars 2026		Komuna e Vushtrisë	DKRS	
2.4. Dita Ndërkombëtare e Librit	2.4.1. Tryezë me të rinjtë dhe me nxënës për vlerën që ka libri	23 prill 2026	300.00 €	Komuna Vushtri	DKRS DKA	
2.5. Dita Botërore e Monumenteve dhe Vëndbanimeve Historike	2.5.1. Vizita nëpër disa vëndbanime historike	18 prill 2026	250.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	
2.6. Dita e Evropës	2.6.1. Turne në futboll të vogël 2.6.2. Diskutim me nxënës të shkollave të mesme të larta	9 maj 2026	1,000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS DKA	
2.7. Dita Ndërkombëtare të Muzeve	2.7.1. Aktivitet me fëmijë “së bashku ta pasurojmë Muzeun e Vushtrisë”.	18 maj 2026	2,000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	

	2.7.2. Ekspozita muzeale						
2.8. Përvjetori i “Muzeut Historik-Etnografik	2.8.1. Aktivitet me rasiu e 20 vjetori të themelimit të muzeut me piktorë profesional për shënimin e kësaj dite.		9 qershor 2026	1.000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	
2.9. Mbështetja e piktorëve	2.9.1. Ekspozita të pikturave		Shkurt – dhjetor 2026	2,000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	
2.10. Mbështetja e solistëve	2.10.1. Përgatitje të këngëve dhe albumeve		Shkurt – dhjetor 2026	2,000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	
2.11. Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	2.11.1. Aktivitete kulturore me fëmijë		1 qershor 2026	1,500.00 €	Komuna Vushtri	DKRS DKA	
2.12. Deklarate 2 korrikut 1990	2.12.1. Tryezë shkencore dhe aktivitete informuese që ndërliidhen me këtë ngjarje		2 korrik 2026	900.00 €	Komuna Vushtri	DKRS DKA	
2.13. Ditët e Diasporës	2.13.1. Aktivitete të ndryshme kulturore, artistike e sportive për diasporën, përfshirë koncerte dhe shfaqje të ndryshme		Korrik dhe gusht 2026	6,000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS DKA dhe Drejtoria e Diasporës	
2.14. Dita Ndërkombëtare e Rinisë	2.14.1. Aktivitete rinore dhe sportive		12 gusht 2026	1,500.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	

2.15. Ditët e Hasan Prishtinës	2.15.1. Homazhe	12,13 dhe 14 gusht 2026	1,000.00 € 3,000.00 € 1,500.00 €	Komuna Vushtrri	DKRS	
2.16. Dita e Kushtetutës së Kaçanikut (7 shtator 1990)	2.16.1. Vizitë objektit në Kaçanik ku është miratuar kushtetuta	7 shtator 2026	500.00 €			
2.17. Java Ndërkombëtare e të Shurdhërve	2.17.1. Aktivitet mbështetës për komunitetin e të shurdhërve	22 shtator 2026	500.00 €	Komuna Vushtrri	DKRS	Shoqata e të Shurdhërve
2.18. Shfaqje Teatrale	2.18.1. Shfaqje nga Teatri i qytetit	Shtator 2026	10,000.00 €	Komuna Vushtrri	DKRS	
2.19. Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore	2.19.1. Ligjërata për Trashëgiminë Kulturore	29 shtator 2026	250.00 €	Komuna Vushtrri	DKRS	
2.20. Festivali “Takimet e Poeteshave Shqiptare”	2.20.1. Mbrëmja poetike e poeteshave 2.20.2. Vizitë qytetit të Vushtrrisë 2.20.3. Ekspozitë me piktura	3 dhe 4 nëntor 2026	5,000.00 € 1,000.00 €	Komuna Vushtrri	DKRS	
2.21. Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve	2.21.1. Aktivitet mbështetës për të moshuarit 2.21.2. Ligjërata të rinjve për ndërgjegjësimin dhe kujdesin ndaj të moshuarve	1 tetor 2026	500.00 €	Komuna Vushtrri	DKRS	
2.22. Festivali i Patates	2.22.1. Aktivitet me bujq dhe fermer	Tetor 2026	1,000.00 €	Komuna Vushtrri	DKRS	D. Bujqësisë

2.23. Java e shkopit të bardhë	2.23.1. Aktivitete mbështetëse ndaj komunitetit.		15-22 tetor 2026	1, 000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS Shogata e të verbërve	
2.24. Dita Ndërkombëtare e Arkeologjisë	2.24.1. Aktivitete, ligjerata dhe vizita në disa lokalitete arkeologjike		20 tetor 2026	500.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	
2.25. Festivali i pikturës “Kolonia e Artit”	2.25.1. Aktivitete te ndryshme kulturo-artistike		Nëntor 2026	5,000.00 €	Komuna e Vushtrisë	DKRS, DKA dhe OJQ që ndërliohen me këtë aktivitet	
2.26. Shtafje teatrale për fëmijë	2.26.1. Shtafje teatrale për fëmijë nga Teatri i Qytetit		Dhjetor 2026	10,000.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	
2.27. Dita Ndërkombëtare e personave me aftësi të veçanta	2.27.1. Aktivitet mbështetës për komunitetin e njerëzve me nevoja të veçanta		3 dhjetor 2026	1,500.00 €	Komuna Vushtri	DKRS HANDIKOS	
2.28. Shpallja e Sportistit të Vitit 2025	2.28.1. Aktivitet me sportistët vushtrias dhe ceremonia e ndarjes së çmimeve		Janar 2026	3,500.00 €	Komuna Vushtri	DKRS	

Gjeodezi Kadaster Pronë

Nr	Drejtoria	Objektivat	Aktivitetet	Afai	Kostoja	Pjesëmarrësit	Ndërlidhja
1	Drejtoria Gjeodezi e Kadaster	Shpronësim i pronave për realizimin e projekteve	Zhvillimi i procedurave të	Afaii perm anen	Ndikimi financiar nuk është përcaktuar me buxhet	Pjesëmarrësit tjerë Ministria e Financave	Ndërlidhja me realizimin e projekteve me interes për Komunën dhe qytetarët

		shpronësi mit			
Prioritet nr. 1 Shpronësimi					
prioritet nr. 2 Uzurpimet					
2	Objektivat Mbrotjta e pronës komunale	Zhvillimi i procedura ve për lirimimin e pronës komunale të uzurpuar	Afati perm anen t	Ndikimi financiar Në Euro zero	Pjesëmarr ësit tjerë Drejtoria e Inspeksion it
3	Objektivat Zbatimi i Aktvendimeve lidhur me ndarjen e pronës nga Komasacioni, të lëshuar nga Komisioni për komasacion	Futja e të dhënave në RDPP për zonat kadastrale në komasacion n të pa përfundua ra	Afati perm anen t	Ndikimi financiar Në euro zero	Pjesëmarr ësit tjerë Agjension i Kadastral i Kosovës
4	Raportimi para Kuvendit të Komunës lidhur me pronat komunale	Informatë lidhur me pronat komunale të dhëna me qira	Mua aji shtat or	Ndikimi financiar, zero	
5	Lista e pronave të paluajtshme të Komunës	Përpilimi dhe azhurimi i listës së	Afati perm anen t	Ndikimi financiar zero euro	Pjesëmarr ës tjerë Drejtoria

			përgjithshme dhe të veçantë të pronave komunale të paraparë sipas ligjit		për Bujqësi	
5	Objektivat Ngritja e efikasitetit në punë	Përgjigjja në kohë ndaj kërkesave	Afat i per manent	Ndikimi financiar Në euro zero		

Inspektimet

Inspektoriati i Tregut		
OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETI	Inspektimet	Të hyra
Objekti i Inspektoratit të Tregut: Mbikëqytjen inspektuese në përbushjen e standardeve të mallrave pas vendosjes së tyre në treg dhe të shërbimeve, parandalimi i ekonomisë informale, çmimet, përcaktimin dhe ekspozimin e çmimeve, reklamimin e produkteve dhe shërbimeve, pagesën dhe dhënien e faturave, mbrojtjen e konsumatorëve, qarkullimin e produkteve nga metalet e çmuara, mbikëqytjen inspektuese të veprimtarive turistike dhe hoteliere, veprimtarinë zejtare, të tregutit të duhanit, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në treg, mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme në treg, mbikëqytjen inspektuese të sigurisë e produkteve në treg, përshtatshmërinë teknike të produkteve, reagimi në kohë ndaj kërkesave/ankesave të qytetarëve dhe institucioneve të tjera, si dhe punë të tjera të përcaktuara me Ligji dhe akte nën ligjore.	Janar-Mars 20 inspektime Prill-Qershor 50 inspektime Korrik-Shtator 70 inspektime Tetor-Dhjetor 60 inspektime Gjithsejtë 200 Inspektime	Janar-Mars 600.00 € Prill-Qershor 500.00 € Korrik-Shtator 500.00 € Tetor-Dhjetor 1200.00 € Gjithsejtë 2,800.00 €
	Të hyra nga PËLQIMET, lidhur me Plotësimin e Kushteve Minimale Teknike 6,000.00 €	

Bazuar në planin e punës e në përputhje me ligjet në fuqi, Inspektorati i Tregut do të ndërmarr të gjitha masat administrative sa i përket tregimit të mallrave e në veçanti angazhim i përhershëm në luftimin e tregtisë in formale. Përimi kryesor do të jetë tregtimi i lirë i mallrave në mënyrë legale si dhe siguria e përgjithshme të produkteve për një ambient më të shëndosh.

Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit	
OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETI	Inspektime
Objektivi i Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit:	
- Parandalimi i ndotjes së Mjedisit në tokë ujë dhe ajër, - Mbrojtjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale, - Mbrojtjen inspektuese për burimet e palëvizshme të ndotjes së ajrit, - Mbrojtjen inspektuese në zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, - Zbatimin e mbikëqytjes të vlerave të mbrojtura të natyrës dhe në pjesët tjera të natyrës, - Mbrojtjen inspektuese të ujërave në nivele komunale - Mbrojtjen Inspektuese për menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës përkatëse, si dhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe akte nën ligjore. - Aktiviteti i Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit : - Angazhimi në zvogëlimin e faktorëve të ndotjes së mjedisit jetësorë - Analiza në vlerësime dhe rekomandime në lëmin e industrisë dhe burimeve urbane . - Angazhimi në edukimin dhe në vetëdijesimin e popullatës në lëmin e Mbrojtjes së Mjedisit - Angazhimi në edukimin dhe në vetëdijesimin e popullatës në lëmin e Mbrojtjes së Mjedisit - Inspektimi i bizneseve dhe ndërtimeve rreth zbatimit të lejeve mjedisore komunale	Janar-Mars 15 inspektime Prill-Qershor 20 inspektime Korrik-Shtator 30 inspektime Tetor-Dhjetor 25 inspektime Gjithsejtë 90 Inspektime

- Inspektimi i ndërmarrjes publike NPL, Përpunimi, bizneseve dhe ekonomive familjare rreth aktivitetit të mbeturinave, ripërdorimin dhe riciklimin e tyre kryesisht në zonat rurale - Inspektimi i lumenjve “Simnica” dhe “Tërstenat” në mënyrë që shtrati i këtyre lumenjve të ketë panje freskuese dhe të pastër. - Inspektimi për mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma dhe vibrationet nga burimet e ndotjes. - Inspektimi i për gjelbërimin dhe mirëmbajtjen e parqeve të qytetit. - Angazhimi në zvogëlimin e ndotjes nga transporti - mbikëqytjen dhe aplikimin e të gjitha procedurave juridike në rastet e konstruktimit të projekteve zhvillimore në zonat e mbrojtura të natyrës, kushtet, lejet si dhe zhvillimin e punëve se a janë në harmoni me lejen e dhënë.	
--	--

Objekti i Inspektoratit të Ndërtimit:

Inspektimin e ndërtimeve sipas lejes së ndërtimit ku përfshin ngritjen, instalimin, renovimin dhe zgjerimin e ndërtësive, verifikimin e dokumenteve burimore, inspektimin e ndërtimit të destinimit dhe rrënimin e çfarëdo ndërtëse apo strukture, kushtet sipas lejes së ndërtimit, nxjerrjen e vendimeve për ndalimin e punimeve, deri në mënjanimin e parregullsive, vendim për rrënimin e objektit pa leje, nxjerrjen e vendimeve për mbylljen e vend ndërtimit, reagimi në kohë ndaj kërkesave/ankesave të qytetareve dhe institucioneve të tjera, si dhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nën ligjore.

Aktiviteti i Inspektoratit të Ndërtimit:

Inspektimin me qëllim identifikimin e personave fizik apo juridik që veprojnë në kundërshtim me ligjet përkatëse në fushën e ndërtimit, ndalimin e punëve ndërtimore ilegale, shqiptimi i gjobave, fillimin e procedurave kundërvajtëse dhe penale kur konstatohen shkelje të dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera nën ligjore përkatëse, inkasimi i të hyrave nga shqiptimi i gjobave.

Punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe akte tjera nën ligjore në fuqi.

Inspektimin me qëllim identifikimin e personave fizik apo juridik që veprojnë në kundërshtim me ligjet përkatëse në fushën e ndërtimit, ndalimin e punëve ndërtimore ilegale, shqiptimi i gjobave, fillimin e procedurave kundërvajtëse dhe penale kur konstatohen shkelje të dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera nën ligjore përkatëse, inkasimi i të hyrave nga shqiptimi i gjobave. Punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe akte tjera nën ligjore në fuqi.	Janar-Mars 10 inspektime	Janar-Mars -
	Prill-Qershor 20 inspektime	Prill-Qershor 600.00 €
	Korrik-Shtator 20 inspektime	Korrik-Shtator 600.00 €
	Tetor-Dhjetor 25 inspektime	Tetor-Dhjetor 500.00 €
	Gjithsejtë 75 Inspektime	Gjithsejtë 1,700.00 €

Inspektorati i Shërbimeve Publike		
OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETI		
Objektivi i Inspektoratit të Shërbimeve Publike:	Inspektime	Të hyra
	Janar-Mars 45 inspektime	Janar-Mars 500.00 €
	Prill-Qershor 80 inspektime	Prill-Qershor 500.00 €
	Korrik-Shtator 80 inspektime	Korrik-Shtator 500.00 €
	Tetor-Dhjetor 80 inspektime	Tetor-Dhjetor 500.00 €
	Gjithsejtë 285 inspektime	Gjithsejtë 2,000.00 €
Aktiviteti i Inspektoratit të Shërbimeve Publike: Inspektimin e personave fizik dhe juridik me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike, inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike nga shfrytëzuesit e pa autorizuar, mjedisit për sa i përket mbeturinave, mbikëqyrjen e bartjes dhe deponimit të mbeturinave, mbikëqyrjen e gjelbërimit, ndriçimi publik nga dëmtuesit potencial, lëshimin e urdhërësave ndaj personave fizik apo juridik për mënjanim të parregullsive, parandalimin e dëmtimit të sipërfaqeve publike nga personat fizik apo juridik, shqiptimi i gjobave, fillimin e procedurave kundërvajtëse dhe penale kur konstatohen shkelje të dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera nën ligjore përkatëse, inkasimi i të hyrave nga shqiptimi i gjobave. Punë të tjera të përcaktuara me akte tjera ligjore në fuqi.		

Inspektorati i Komunikacionit		
Objektivi dhe Aktiviteti	Inspektime	Të hyra
Objektivi i Inspektoratit të Komunikacionit: Mbiqëqyrja dhe inspektimi i të gjithë operatorëve që merren me veprimtarinë mbi transportin e udhëtarëve dhe mallrave, Inspektimi i Auto-Taxi-ve Operatorët "Taxi" Inspektimi i automjeteve të transportit të mallrave Ndërmarrjet të cilat merren me transport të udhëtarëve (Autobusët, Kombi busët) Kontrollimin e vijave Komunale urbane dhe nder urbane. Angazhimi i kryerjes së detyrës me përpikëri si dhe punët dhe detyrat që merren nga drejtori i Drejtorisë për Inspektime. Bashkëpunoj me subjektet relevante - Policia e Kosovës, Gjykatën, Inspektoratet qendrore dhe Komunale Drejtorin për Shërbime publike Drejtorin për Shërbime publike Bashkëpunim me qytetar Inspektoratet e resorëve tjera Drejtorin për Shërbime publike.	Janar-Mars 20 inspektime Prill-Qershor 25 inspektime Korrik-Shtator 25 inspektime Tetor-Dhjetor 20 inspektime Gjithsejtë 95	Janar-Mars 100 € Prill-Qershor 150 € Korrik-Shtator 150 € Tetor-Dhjetor 100 € Gjithsejtë 500.00 €

OBJEKTIVAT E DREJTORISË PËR PUNË INSPEKTUESE (DPI) 2026

1.	Rritja e besueshmërisë ndaj inspektoratit nëpërmjet trajtimit dhe zgjidhjes së të gjitha ankesave të ardhura nga personat juridik apo fizik.
2.	Rritja e inspektimeve me qellim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe akteve tjera nën ligjore në fuqi, mbrojtjen e konsumatorëve, qytetarëve dhe të mirave të interesit të përgjithshëm.
3.	Transparenca do të luaj një rol të rëndësishëm në raport me subjektet ku zbatimi i standardeve dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të inspektoratit si dhe fushata senzibilizuese publike për rritjen e ndërgjeshmërisë së qytetarëve do të jenë fokus i drejtorisë.
4.	Evidentimi dhe marrja e masave për të gjitha rastet ku dyshohet së është shkelur Ligji e që janë në kuadër të kompetencave të inspektorëve si dhe realizimi i të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga objektivat strategjike dhe politike të qeverisjes qendrore dhe lokale.
5.	Plan-programi i punës mund të ndryshoj vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe në raste të aksioneve të përbashkëta me Inspektorët tjerë të nivelit qendror dhe ndër Komunal mbështetur në ligjshmëri, si dh me kërkuesin e Kryetarit të Komunës, Drejtorit të Drejtorisë për Inspektime .

Bujqësi

Nr.	Prioritetet	Aktivitetet e planifikuara	Koha e implem-entimit	Buxheti €	Akterët implemen-tuese të projektit
1	Hartimi i planeve dhe raporteve për drejtorinë e BZHR	Hartimi i planit të punës për vitin 2026. Hartimi i raportit të punës për vitin 2025	dhjetor 2025 janar 2026	-	Drejtoria e BZHR
2	Hartimi i propozim vendimeve, shqyrtimi dhe përgjigjja në kërkesa, hartimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit etj.	Hartimi i të gjithave akteve dhe vendimeve në kohë të duhur. Shqyrtimi dhe përgjigjja e të gjitha kërkesave në afat brenda kornizave ligjore. Përfqësimi në institucione shtetërore	Janar-dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e BZHR
3	Përgatitja e projekteve-para masave.	Hartimi i propozim projekteve-para masave, shpalljeve me të gjitha aktet përcjellëse	Janar-tetor	-	Drejtoria e BZHR
4	Shërbime për fermerë në kuadër të marrëveshjes me MBPZHR	Regjistrimi dhe ndryshimet eventuale të fermerëve në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të fermave në EFR. Aplikimi i fermerëve për subvencione të shpallura nga MBPZHR, digitalizimi me ELPIS, pranimi i dokumentacionit, dorëzimi në AZHB.	Janar-dhjetor	-	Drejtoria e BZHR

5	Shërbime për fermerë	Angazhimi në Programin e Shërbimeve Këshillimore të MBPZHR për fermerë Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve për fermerë, Organizimi i vizitave si te vet fermerët ashtu edhe të fermerëve të komunës nëpër komuna tjera.	Janar – dhjetor		Drejtoria e BZHR
6	Ngritja e komisioneve, hartimi i raporteve për nevoja të Komunës dhe MBPZHR	Planifikimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore- raportimi. Formimi i komisionit për procesin e korrjes së drithërave, përcjellja e procesit – raportimi.	Janar - dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e BZHR
7	Bashkëpunimi me OJQ dhe akterëve tjerë	Vazhdimi i bashkëpunimit me OJQ me të cilat jemi duke bashkëpunua si dhe angazhimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me OJQ vendore dhe ndërkombëtare	Janar- dhjetor	-	Kryetari i Komunës, Drejtoria e BZHR

Mbrojtje dhe Shpëtim

Plani vjetor i punës për vitin 2026 i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) në Komunën e Vushtrrisë është hartuar në përputhje me kompetencat komunale në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, bazuar në Ligjin për Mbrojtje dhe Shpëtim nga Fatkeqësitë Natyrore dhe nga Fatkeqësitë e Tjera, si dhe në aktet nënligjore dhe politikat përkatëse.

Ky plan parqet një dokument strategjik dhe operativ që përcakton objektivat, aktivitetet, përgjegjësitë, afatet kohore dhe burimet financiare për realizimin e detyrave të DMSH-së gjatë vitit 2026.

Qëllimi i hartimit të Planit:

- Përcaktimi i prioriteteve dhe detyrave sipas dinamikës së punës për vitin 2026
- Rritja e koordinimit ndërinstitucional në nivel lokal, rajonal dhe qendror
- Sigurimi i reagimit të shpejtë dhe profesional ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera
- Koordinimi efektiv i ekipeve emergjente me subjektet përgjegjëse për menaxhimin e situatave emergjente
- Zvogëlimi i rezikut dhe minimizimi i pasojave ndaj jetës së qytetarëve, pronës dhe mjedisit

REZULTATI 1: Zvogëlimi i rezikut nga fatkeqësitë dhe rritja e sigurisë publike

Nr.	Objekti Operativ	Aktivitetet Kryesore	Treguesit e Performancës	Afati Kohor	Kosto (€)	Burimi Financiar	Përgjegjësia
1.1	Parandalimi i rezikut nga vërshimet dhe trëshqitjet e dheut	Intervene preventive dhe emergjente me makineri të rëndë	Nr. i intervenimeve të realizuara	Gjatë vitit, sipas nevojës	150,000.00	Komuna Vushtri	DMSH
1.2	Përmirësimi i qasjes dhe sigurisë në infrastrukturën rrugore rurale	Riparimi dhe rehabilitimi i rrugëve të rendit të katërt, shtruarja e zhavorrit	Km rrugë të rehabilituara	Gjatë vitit	55,806.00	Komuna Vushtri	DMSH
1.3	Zvogëlimi i rezikut sanitar dhe të sigurisë nga qentë endacak	Trajtimi dhe menaxhimi i qenve endacak në hapësira publike	Nr. i rasteve të trajtuara	Gjatë gjithë vitit	50,000.00	Komuna Vushtri	DMSH

REZULTATI 2: Rritja e gatishmërisë operative dhe kapaciteteve për reagim emergjent

Nr.	Objekti Operativ	Aktivitetet Kryesore	Treguesit	Afati Kohor	Kosto(€)	Burimi Financiar	Përgjegjësia
2.1	Forcimi i mekanizmave lokal për menaxhimin e emergjencave	Koordinimi me NJPZSH, PK, FSK, KFOR, OJQ dhe Kryqin e Kuq	Nr. i takimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta	Gjatë vitit	-	-	DMSH
2.2	Kordinimi dhe raportimi në bazë të Procedurave Standarde Operative	Koordinimi me Zyra e Alarmit dhe koordinimit emergjent (ZAKE)	Nr. i njoftimeve dhe raportimeve	Gjatë vitit	-	-	DMSH, AME, ZAKE

2.3	Rritja e gatishmërisë institucionale për reagim të shpejtë	Pjesëmarrja aktive në KKSBB	Nr. i takimeve	Çdo 2 muaj	-	-	DMSH / KKSBB
------------	--	-----------------------------	----------------	------------	---	---	--------------

REZULTATI 3: Planifikimi, koordinimi dhe menaxhimi efektiv administrativ

Nr.	Objekti Operativ	Aktivitetet Kryesore	Treguesit	Afati Kohor	Kosto	Burimi Financiar	Përgjegjësia
3.1	Sigurimi i planifikimit të qëndrueshëm dhe raportimit institucional	Hartimi i planeve vjetore, javore dhe periodike	Plane dhe raporte të përgatitura në afat	Gjatë vitit	-	-	DMSH
3.2	Zbatimi i legjislaacionit dhe dokumenteve strategjike	Azhurnimi i Planit Operativ Emergjent	Plani i miratuar	Gjatë vitit	-	-	DMSH
3.3	Menaxhimi efikas i burimeve njëzore	Hartimi i planeve të pushimeve vjetore	Plani i aprovuar	Shkurt – Mars	-	-	DMSH
3.4	Fleksibilitet institucional ndaj situatave të paparashikuara	Realizimi i detyrave jashtë planit të rregullt	Detyra të realizuara sipas nevojës	Janar – Dhjetor	-	-	DMSH

REZULTATI 4: Informimi publik dhe mbrojtja e popullatës civile

Nr.	Objekti Operativ	Aktivitetet Kryesore	Treguesit	Afati Kohor	Kosto	Burimi Financiar	Përgjegjësia
4.1	Rritja e vetëdijes publike për trezizet dhe masat mbrojtëse	-Informimi i qytetarëve përmes ZAKE dhe kanaleve zyrtare -Bashkëpunimi me shkollat për edukim të nxënësve	Nr. i aktiviteteve informuese	Gjatë vitit	-	-	DMSH, Drejtoria e Arsimit

Diaspora

Diaspora e Komunës së Vushtrisë paraqet një potencial të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komunës. Ky Plan Pune është hartuar me qëllim të forcimit të bashkëpunimit institucional me diasporën, ofrimit të shërbimeve efikase dhe krijimit të kushteve për përfshirjen e saj aktive në zhvillimin lokal gjatë vitit 2026.

Objektivat Strategjike

- 1 Evidentimi dhe regjistrimi i diasporës së Komunës së Vushtrisë
- 2 Përmirësimi i komunikimit dhe informimit të diasporës
- 3 Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar
- 4 Nxitja e kontributit ekonomik të diasporës në zhvillimin lokal
- 5 Koordinimi ndërinstitucional dhe bashkëpunimi me shoqatat e diasporës

Objektivat Specifike dhe Aktivitetet

Objektivi 1 : Regjistrimi dhe Evidentimi i Diasporës

- Krijimi dhe mirëmbajtja e databazës së diasporës
- Bashkëpunim me shoqata dhe individë nga diaspora
- Azhurnim periodik i të dhënave

Afati: Janar–Dhjetor 2026

Përgjegjës: Drejtoria për Diasporë

Objektivi 2: Komunikimi dhe Informimi

- Funksionalizimi i pikës së kontaktit për diasporën
- Organizimi i takimeve online/informuese (min. 4 në vit)
- Krijimi i rubrikës për diasporën në ueb-faqen e komunës

Objektivi 3: Ruajtja e Identitetit dhe Aktivitetet Kulturore

- Mbështetje për aktivitete kulturore dhe artistike të diasporës
- Organizimi i manifestimit “Ditët e Diasporës në Vushtri”
- Mbështetje për mësimin plotësues në gjuhën shqipe

Objektivi 4: Diaspora dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal

- Takime me biznese të diasporës gjatë sezonit veror
- Promovimi i mundësive për investime në komunë

Objekti 5: Koordinimi dhe Raportimi

- Koordinim me institucionet qendrore dhe lokale
- Raportim gjatëmuor dhe vjetor për realizimin e planit

Buxheti i përgjithshëm i planifikuar : 50,000.00 €

Ky plan si i tillë mund të evoluoj përkatësisht ndryshoj apo plotësohet varësisht nga nevojat dhe realizimi i buxhetit brenda vitit 2026. Mirëpres sugjerimet gjatë diskutimeve në kuvend të cilat do të mund të inkuorohen në tekstin e këtij plani apo bashkëngjiten në shtojcë.

Ferit Idrizi



Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Datë 23.12.2025

Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe Hartues: kryesuesja e Kuvendit znj. Melihate Basholli-Latifi

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marrë për bazë kërkesën për rishqyrtimi e aktit komunal, me numër të referencës Nr.378-V/2025 e datës 24.02.2024 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me vendimin **25196/25** i datës 03.06.2025, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 2025 merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NR.25196/25 I DATËS 03.06.2025

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **Nr. 25196/25 i datës 03.06.2025**, për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. “Ismail Parduzy” në Vushtri, sipas gjendjes faktike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.
3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke ju referuar shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit-vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë vendimi me numër të protokollit Nr.25196/25 i datës 03.06.2025 për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës - ri rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzy" në Vushtri sipas gjendjes faktike, e cila ka kërkuar që ky vendim të harmonizohet me legjislacionin duke respektuar nenin 43 pika 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

43.3 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohej, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Kryesuesja e kuvendit duke marrë dhe përmbushur këto obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju dërgon për rishqyrtim dhe harmonizim vendimin e cekur si më lartë.

Andaj bazuar në cekurat më lartë obligohet Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë përcjellëse ju dërgojmë vendimin dhe shkresat përcjellëse.

Duke marr në konsideratë këto vlerësime si dhe duke përmbushur obligimet ligjore që derivojnë nga legjislacionin në fuqi në fushën e vetëqeverisjes lokale, i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që aprovoj këtë propozim-vendim së në dispozitiv të tij.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUÇITRN	
Nr. / Br.	25196/25
Nr. / Iq. / Br. at.	2
Data: / Datum:	09.06.25
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vuçitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 93/25 05/06/2025

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), nenit 24, nenit 25 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 29, 30 dhe 31 të Rregullores (QRK)nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **03 qershor 2025**, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. “Ismail Parduzy” në Vushtri, sipas gjendjes faktike

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ariani Company SH.P.K me përfaqësues Naser Imeri.
2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-6570-0** në sipërfaqe prej **161m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **5267m²** ZK Vushtri pronë e Ariani Company SH.P.K, me pjesë nga parcela kadastrale **P-70202016-1106-1-0**, në sipërfaqe prej **161 m²**, nga sipërfaqja e përgjithshme prej **3707m²** ZK Vushtri, pronë e Komunës Vushtri. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës- kyqje në rrugën publike në Rr. “Gjon Buzuku”, bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.
3. Këto prona iu janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
4. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Refik Maloku

Anëtar i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITR
Nr./No. 34823 / 25
Nr./No. / Hq./Hq. -2-
Data / Datum: 21.07.2025
VUSHTRRI - VUČITR
Republika e Kosovës



Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr.122/25 21.07.2025

DATË/DATA/DATE:	21 korrik 2025
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	znj. Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për rishqyrtimin të vendimit

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Duke ju referuar shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit-vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë vendimi me numër të protokollit Nr.25196/25 i datës 03.06.2025 për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës - ri rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzy" në Vushtri sipas gjendjes faktike, e cila ka kërkuar që ky vendim të harmonizohet me legjislacionin duke respektuar nenin 43 pika 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

43.3 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:


- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Kryesuesja e kuvendit duke marrë dhe përmbushur këto obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju dërgon për rishqyrtim dhe harmonizim vendimin e cekur si më lartë.

Andaj bazuar në cekurat më lartë obligohet Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që të ndër marrë veprimet e nevojshme të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë përcjellëse ju dërgojmë vendimin dhe gjitha shkresat e kësaj lënde.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministartvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrisë Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPI. Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPI-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPI-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPI.	Datë: 04.07.2025 VL-020-379
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Martin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e aktit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 25196/25 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismael Parduzy" në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

I miratuar më datë: 03.06.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPI më datë: 13.06.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas rishqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetimi

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur me datë: 03.06.2025 ka miratuar, Vendimin Nr. 25199/25 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.

Në raportin e monitorimit është evidentuar se në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë, të mbajtur me datë: 03.06.2025, lidhur me vendimin e lartshënuar një drejtor i ekzekutivit të Komunës, për rendin e ditës ka propozuar shtimin e 3 pikave shtesë për rendin e ditës gjatë zhvillimit të seancës, njëra prej tyre është edhe vendimi i cekur më lartë:

- Propozim-vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës në rr. "Ismail Parduzi" në Vushtrri, sipas gjendjes faktike.

Rrjedhimisht propozimi i 3 pikave shtesë, aty për aty nga anëtari i ekzekutivit të Komunës së Vushtrisë, është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke marr për bazë edhe se anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk janë informuar me kohë për çështjet që janë objekt i trajtimit, nuk kanë poseduar materialet për pikat shtesë që do të diskutohen ashtu siç parashihet në nenin 43, pika 43.3, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale që përcakton:

"Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, shtatë (7) ditë para mbajtjes së mbledhjes", në njoftim përfshihen:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
 - b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
 - c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
 - e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Njoftimi nga paragrafi 3 dhe 4, të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, duhet gjithashtu t'i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Poashtu është në kundërshtim me nenin 47 pika 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale që përcakton: *se anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.*

Për më tepër, Lidhëzimi Administrativ (MAPI) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, neni 7, përkufizon se çka mund të konsiderohet urgjente, e ku bëjnë pjesë fatkeqësisht natyrore dhe çështje të natyrës së ngjashme.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë duhet që të ndërmerr veprime të rishqyrtojë aktin dhe harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Datë 23.12.2025

Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe Hartues: kryesuesja e Kuvendit znj. Melihate Basholli-Latifi

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marrë për bazë kërkesën për rishqyrtimi e aktit komunal, me numër të referencës Nr.378-V/2025 e datës 24.02.2024 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me vendimin **25199/25** i datës 03.06.2025, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më **2025** merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NR. 25199/25 I DATËS 03.06.2025

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **Nr. 25199/25** i datës **03.06.2025**, **Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës te SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtri, sipas gjendjes faktike**
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.
3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke ju referuar shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit-vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë -vendimi me numër të protokollit Nr.25199/25 i datës 03.06.2025 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës -ri rregullim të kufirit të pronës të SHMU Ali Kelmendi në Vushtri sipas gjendjes faktike, e cila ka kërkuar që ky vendim të harmonizohet me legjislacionin në fuqi duke respektuar nenin 43 pika 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, i cili përcakton citojmë:

43.3 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohej, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Kryesuesja e kuvendit duke marrë dhe përmbushur këto obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju dërgon për rishqyrtim dhe harmonizim vendimin e cekur si më lartë.

Andaj bazuar në cekurat më lartë obligohet Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që të ndërmarrë veprimet e nevojshme të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë përcjellëse ju dërgojmë vendimin dhe shkresat përcjellëse.

Duke marr në konsideratë këto vlerësime si dhe duke përmbushur obligimet ligjore që derivojnë nga legjislacionin në fuqi në fushën e vetëqeverisjes lokale, i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që aprovoj këtë propozim-vendim së në dispozitiv të tij.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Br.	25999/25
Nr. i fq. / Br. sh.	- 2 -
Data / Datum:	09.06.25
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 94/25 05/06/2025

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale (nr.03/L-040), nenit 24, nenit 25 paragrafi 1,3,4 dhe 6 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 29, 30 dhe 31 të Rregullores (QRK)nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të nenit 19 pika 1.4 të Statutit të Komunës së Vushtrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrisë në mbledhjen e mbajtur më **03 gershor 2025**, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës; ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtri, sipas gjendjes faktike

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bashkësisë Islame në Vushtri.
2. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen kanë këto karakteristika: pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-02253-10, në sipërfaqe prej 59.35m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2492m² ZK Vushtri, pronë e Bashkësisë Islame në Vushtri me përfaqësues Ejup Haziri , me pjesë nga parcela kadastrale P-70202016-02253-24, në sipërfaqe prej 21.41 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 19388m² ZK Vushtri, pjesë nga parcela P-70202016-02253-3, në sipërfaqe prej 37.94m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 8259m², pronë e Komunës Vushtri. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për zgjerimin e rrugës publike në fjalë bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.
3. Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme pranë Departamentit për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
4. Pronat e paluajtshme që do të këmbehen, të përshkruara në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.


5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

Refik Maloku



Anëtar i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrisë Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrisë	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve të MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbil Hetemir, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL	Datë: 04.07.2025 VI-020-379
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e aktit	
Tloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 25199/25 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

I miratuar më datë: 03.06.2025

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 13.06.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës, si më sipër, vlerëson se akti i Komunës, nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetimi

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 03.06.2025 ka miratuar, Vendimin Nr. 25199/25 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

Në raportin e monitorimit është evidentuar se në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, të mbajtur me datë: 03.06.2025, lidhur me vendimin e lartshënuar një drejtor i ekzekutivit të Komunës, për rendin e ditës ka propozuar shtimin e 3 pikave shtesë për rendin e ditës gjatë zhvillimit të seancës, njëra prej tyre është edhe vendimi i cekur më lartë:

- Propozim-vendimi për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës ri-rregullim të kufirit të pronës të SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtri, sipas gjendjes faktike.

Rrjedhimisht propozimi i 3 pikave shtesë, aty për aty nga anëtarë i ekzekutivit të Komunës së Vushtrrisë, është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke marr për bazë edhe se anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk janë informuar me kohë për çështjet që janë objekt i trajtimit, nuk kanë poseduar materialet për pikat shtesë që do të diskutohen ashtu siç parashihet në nenin 43, pika 43.3, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale që përcakton:

"Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes", në njoftim përfshihen:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
 - b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
 - c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
 - d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
 - e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Njoftimi nga paragrafët 3 dhe 4, të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, duhet gjithashtu t'i dërgohet Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale.

Poashtu është në kundërshtim me nenin 47 pika 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale që përcakton: se anëtarë i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

Për më tepër, Lidhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, neni 7, përkufizon se çka mund të konsiderohet urgjente, e ku bëjnë pjesë fatkeqësisht natyrore dhe çështje të natyrës së ngjasme.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë duhet që të ndërmerr veprime të rishqyrtojë aktin dhe harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS - RYTOBHJA E KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRË	
Nr./Br.	34 822/23
Nr. i fq./Br. sh.	2
Data/ Datum	21.07.25
VUSHTRRI - VUČITRË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrë – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr.121/25 21.07.2025

DATË/DATA/DATE:	21 korrik 2025
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
NGA/OD/FROM:	znj. Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për rishqyrtimin e vendimit

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Duke ju referuar shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit-vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë -vendimi me numër të protokollit Nr.25199/25 i datës 03.06.2025 për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private, zgjerimin e rrugës -ri rregullim të kufirit të pronës të SHMU Ali Kelmendi në Vushtri sipas gjendjes faktike, e cila ka kërkuar që ky vendim të harmonizohet me legjislacionin në fuqi duke respektuar nenin 43 pika 43.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, i cili përcakton citojmë:

43.3 Të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet:

- a) data e mbajtjes së mbledhjes;
- b) koha e mbajtjes së mbledhjes;
- c) vendi i mbajtjes së mbledhjes;
- d) rendi i ditës për mbledhje; dhe
- e) materialet e mbledhjes.
- f) të dhëna të tjera që mund të përcaktohen me Statut ose Rregullore të Punës.

Kryesuesja e kuvendit duke marrë dhe përmbushur këto obligimet ligjore që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimi Administrativ për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ju dërgon për rishqyrtim dhe harmonizim vendimin e cekur si më lartë.

Andaj bazuar në cekurat më lartë obligohet Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë që të ndër marrë veprimet e nevojshme të rishqyrtoj aktin në fjalë dhe ta harmonizoj sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur me këtë shkresë përcjellëse ju dërgojmë vendimin dhe gjitha shkresat e kësaj lënde.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Datë 23.12.2025

Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe Hartues: kryesuesja e Kuvendit znj. Melihate Basholli-Latifi

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marrë për bazë kërkesën për rishqyrtimi e aktit komunal, me numër të referencës Nr.1556-2/2024 e datës 17.07.2024 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve lidhur me vendimin Nr.108/24 i datës 03.06.2024, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 2025 merr këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT ME NR.108/24 I DATËS 03.06.2024

1. Me këtë vendim anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **Nr. 108/24 i datës 03.06.2024, lidhur me pagesën e shujtave ditore për zyrtarë të administratës së komunës.**
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke marrë për bazë vlerësimin ligjor të dhënë nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, lidhur me vendimin numër të protokollit Nr. 108/24 i datës 03.06.2024 lidhur me pagesën e shujtave ditore për zyrtarë e administratës së komunës, në ç' rast ministria kompetente, ka konstatuar se akti-vendim në fjalë bie ndesh me Ligjin Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Komuna e Vushtrrisë nuk i ka të ndara mjetet buxhetore për realizmin e këtyre shujtave, andaj ky vendim është i pazbatueshëm.

Duke marr në konsideratë këto vlerësime si dhe duke përmbushur obligimet ligjore që derivojn nga legjislacionin në fuqi në fushën e vetëqeverisjes lokale, i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që aprovoj këtë propozim-vendim së në dispozitiv të tij.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	108 / 24
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	03.06.2024
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridike –OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizike dhe Bashkëfinancim me numër të protokollit Nr. 49/23 datë 23.02.2023, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën **03 qershor 2024**, merr këtë

V E N D I M

PËR PAGESËN E SHUJTAVE DITORE PËR ZYRTARË TË ADMINISTRATËS SË KOMUNËS

1. Me këtë vendim, lejohet pagesa e shujtave në vlerë prej 3.00 € (tri euro) në ditë pune, për zyrtarë të punësuar në Administratën e Komunës së Vushtrrisë.
2. Mjetet financiare nga pika paraprake e këtij vendimi do të sigurohen nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programet si në vijim: zyra e kryetarit kodi buxhetor 16024, Shërbime Publike, kodi buxhetor 18184, Bujqësia kodi buxhetor 47024, Kultura, kodi buxhetor 85024, Arsimi dhe shkenca kodi buxhetor 92120, Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale kodi buxhetor 73033, në shumë prej 240,000.00€ (dyqind e katër dhjetë mijë euro).
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari Komunës, Drejtoria për Buxhet e Financa, Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë, dhe do të zbatohet nga data 03.01.2024.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Datë 23.12.2025

Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe Hartues: kryesuesja e Kuvendit znj. Melihate Basholli-Latifi

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marrë për bazë kërkesën për rishqyrtimi e aktit komunal, me numër të referencës Nr.378-V/2025 e datës 24.02.2024 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve lidhur me vendimin Nr.108/24 i datës 03.06.2025, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 2025 merr këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NR.18/25 I DATËS 30.01.2025

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **Nr. 18/25 i datës 30.01.2025, lidhur me cilin** lejohet ndarja e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore në vlerë prej 100.00 € (njëqind euro) me rastin e festës së Fiter Bajramit, për zyrtarë të punësuar në Administratën e Komunës dhe anëtarë të kuvendit të komunës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Sekretaria e Kuvendit.
3. Ky vendim hynë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim

Duke marrë për bazë vlerësimin ligjor të dhënë nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, lidhur me vendimin numër të protokollit Nr. 18/25 i datës 30.01.2025 lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore në vlerë prej 100.00 € (njëqind euro) me rastin e festës së Fiter Bajramit, për zyrtarë të punësuar në Administratën e Komunës dhe anëtarë të kuvendit të komunës, në ç' rast ministria kompetente, ka konstatuar se akti-vendim në fjalë bie ndesh me Ligjin Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, Komuna e Vushtrrisë nuk i ka të ndara mjetet buxhetore për realizmin e këtyre pagesave, andaj ky vendim është i pazbatueshëm.

Duke marr në konsideratë këto vlerësime si dhe duke përmbushur obligimet ligjore që derivojn nga legjislacionin në fuqi në fushën e vetëqeverisjes lokale, i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë që aprovoj këtë propozim-vendim së në dispozitiv të tij.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRIN	
01 Nr. / Br	18/25
Nr. i fq. / Br. si	-1-
Data: / Datum	30.01.2025
VUSHTRRI - VUČITRIN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 36 paragrafi 1 të Rregullës Financiare të Ministrisë së Financave Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, nenin 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 5 paragrafi 2 i Rregullores (KKV) Nr. 03/23 për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim protokollit. Nr. 49/23 datë 23.02.2023, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30 janar 2025 merr këtë:

V E N D I M


PËR NDARJE TË MJETEVE FINANCIARE PËR FURNIZIM ME PAKO USHQIMORE PËR ZYRTARË TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim, lejohet ndarja e mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore në vlerë prej 100.00 € (njëqind euro) me rastin e festës së Fiter Bajramit, për zyrtarë të punësuar në Administratën e Komunës dhe anëtarë të kuvendit të komunës.
2. Mjetet financiare të cekura si në pikën paraprake të këtij vendimi të sigurohen nga fondi 10, kodi i programit (16024), kategoria: subvencione dhe transfere (200) - Zyra e Kryetarit.
3. Pjesë e këtij vendimi do të jetë lista e punëtorëve të Administratës së Komunës dhe anëtarëve të kuvendit të komunës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Prokurim Publik, Drejtoria për Buxhet e Financa, dhe Zyra e Personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuesë e Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Arton Ahmeti, U.d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Vushtrrisë Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor	Datë: 03.02.2025 VI-020-57
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MFPT	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar vendimin nr. 18/25 të datës 30.01.2025 për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimi nr. 18/25 të datës 30.01.2025 për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës

I miratuar më datë: 30.01.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.01.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Udhëzuesi Org. Indiv. Org. Unit: 02101/1/2025
Nr. i Prot. (Prot. No.): 328-11/2025
Data Datum Date: 24.02.2025
Hr. i Ligjvënës (Legislator):
Hr. i Përkrahës (Supporter):
Dok. No.: PRISHTINE/A



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Data Datum Date: 24.02.2025
Nr. i Prot. (Prot. No.):
Nr. i Ligjvënës (Legislator):
Nr. i Përkrahës (Supporter):
Dok. No.: VI-020-57/5

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera - Ministry of Finance, Labour and Transfers

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrisë	
Kopje:	Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Avni Zogiani, Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Bora Duli, U.d Drejtoresh e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Date: 20/02/2025 Reference: 108/2025
Zyrtarët përgjegjës:	Shqiptar Ibra Zyrtar i Lartë Ligjor, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Kimete Zekaj, Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Vushtrisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Idrizi,
E nderuara Kryesues z. Latifi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

Vendimin nr.18/25 të datës 30.01.2025 për ndarje të mjeteve financiare për furnizim me pako ushqimore për zyrtarë të komunës.
<i>I miratuar më datë 30.01.2025</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 31.01.2025</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 05.02.2025</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të nënshpirtur të Komunës së Vushtrrisë, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Vushtrrisë, me anë të aktit administrativ komunal synon të ndajë mjete financiare për furnizim me pako ushqimore në vlerë prej 100 euro me rastin e festës së Fiter Bajramit për zyrtarët e punësuar në Administratën e Komunës dhe anëtarë të kuvendit të komunës.
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "**LMFPP**") si dhe Ligjin Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2025.
3. Parimi i përgjithshëm i mishëruar në LMEPP është se çdo organizatë buxhetore, në shpenzim të parasë publike, duhet të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore të LMEPP-së, sikurse përcaktohet në nenin 3 të LMEPP-së.
4. Në përmbajtje të LMEPP-së, paratë publike përkufizohen si pasuri financiare ose para të cilat pranohen, janë nën përkujdesjen, mbahen në mirëbesim ose janë nën kontrollin e ndër tjerash, organizatave buxhetore.

5. Ndërsa, në kontekst të shpenzimit të parasë publike, neni 17 i LMFP-së përcakton se shpenzimi i parave publike nga organizatat buxhetore mund të bëhet vetëm për qëllime të miratuara publike, si dhe nga *fondet e ndara dhe të alokuara* [theks i shtuar].
6. Për shqyrtimin e aktit në fjalë duhet marrë parasysh dhe paragrafët 4 dhe 5 të nenit 12 të Ligjit për ndarjet buxhetore:

Neni 12

Limitet në zotime dhe shpenzime

4. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, është i kufizuar në rrethanat kur ka bazë ligjore të qartë sipas këtij ligji; ndonjë ligji tjetër, apo ndonjë akti nënligjor për ato shpenzime, dhe në asnjë mënyrë nuk lejohet që të paguhet shtesa për punonjësit e rregullt nga kjo kategori.

5. Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjisllacionit përkatës si dhe duke përjashtuar pagesën e profesorëve universitar për ofrimin e shërbimit të trajnimit të mësuesve-aktivitet ky i planifikuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI). Ky trajnim realizohet nga profesorët universitar përkatës në përputhje me marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të MASHTI dhe Universitetit të Prishtinës (Fakultetit të Edukimit), e cila marrëveshje rregullon procedurat, afatet, kriteret, mënyrat e pagesës dhe detajet tjera të nevojshme dhe realizohet në përputhje me ndarjet buxhetore përkatëse në MASHTI.

7. Si rrjedhojë, ndarja e mjeteve në vlerën e caktuar për stafin e komunës bie në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
8. Për më tepër, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë për buxhetin e Komunës së Vushtrisë, ku është evidentuar se organizata buxhetore nuk i ka të planifikuara shpenzimet e potencuara me aktin komunal për këtë vit fiskal.
9. Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Vushtrisë nuk është në përputhje me legjisllacionin në fuqi andaj është dhe i pazbatueshëm.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Vushtrisë dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 04.04.2025

Arsim Zuka, U.d Avokat i Përgjithshëm Shtetëror – Avokatura Shtetërore –
Ministria e Drejtësisë

Lënda: Shkresë përcjellëse

I nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën IX të Rregullores së Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë Vendimin Nr. 18/25 të datës 30.01.2025 për ndarje të mjeteve financiare me pako ushqimore për zyrtarë të komunës, i miratuar më 30.01.2025 nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.

Me datë 24.02.2025, MAPL, ka dërguar në Komunën e Vushtrrisë kërkesën për rishqyrtimin e aktit.

Duke pasur për bazë se Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, konform nenit 82.2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nuk ka ndërmarr asnjë veprim konform kërkesës së MAPL-së, për rishqyrtim dhe harmonizim të aktit me legjislacionin në fuqi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, konform nenit 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dërgon Vendimin Nr. 18/25 të datës 30.01.2025 për ndarje të mjeteve financiare me pako ushqimore për zyrtarë të komunës, në gjykatën kompetente për të vendosur lidhur me këtë çështje.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bazë të Rregullores Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, vlerëson se Ministria e Drejtësisë – Avokati i Përgjithshëm Shtetëror është kompetent të dërgoj lëndën në gjykatë në pajtim me ligjin në zbatim të paraparë me neni 82.5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Bazuar në këtë, bashkangjitur gjeni lëndën e kompletuar lidhur me këtë çështje.

Me respekt,

Jeton Qela

Sekretar i Përgjithshëm, MAPL

Kopje: Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së

Kryetari i Komunës së Vushtrrisë,

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,

Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

Datë 23.12.2025

Për Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë

Propozues dhe Hartues: kryesuesia e Kuvendit zni. Melihate Rasholli-Latifi

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040/2008, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marrë për bazë kërkesën për rishqyrtimi e aktit komunal, me numër të referencës Nr.5152-2/25 e datës 15.07.2025 të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës lidhur me vendimin Nr.29309/25 i datës 26.06.2025, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më 2025 merr këtë:

Vendim

Për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë Nr.29309/25 i datës 26.06.2025

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit Nr. 29309/25 i datës 26.06.2025 lidhur me miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin **Bastri-Hajzer Beqiri**, në sipërfaqe prej 100 m², pjesë nga parcela P-70202047-00576-0, nga sipërfaqja e përgjithshme 2100m² pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Dreitoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si dhe

Arsyetim

Duke marrë për bazë vlerësimin ligjor të dhënë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, lidhur me vendimin me numër të protokollit Nr. 29309/25 i datës 26.06.2025 lidhur me miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin **Bastri-Hajzer Beqiri**, në ç' rast ministria kompetente, ka konstatuar se akti-vendim në fjalë bie ndesh me Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, në ç' rast thuhet se caktimi i lokacionit për ngritjen e lapidareve duhet të planifikohet me dokumentet e planifikimit hapësinorët në Komunën e Vushtrisë.

Duke marr në konsideratë këto vlerësime si dhe duke përmbushur obligimet ligjore që derivojnë nga legjislacionin në fuqi në fushën e vetëqeverisjes lokale, i propozojmë Kuvendit të Komunës së Vushtrisë që aprovoj këtë propozim-vendim së në dispozitiv të tij.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Nr.	29309/25
Nr. i llogaritjes / Br. sh.	- 1 -
Data / Datum	27.06.25
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri

Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 113/25 27/06/2025

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, lidhur me nenin 17, paragrafi 11 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **26 qershor 2025** merr këtë:

V E N D I M

**PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS, PËR
CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIM TË LAPIDARIT**

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin **Bastri-Hajzer Beqiri**, në sipërfaqe prej 100 m², pjesë nga parcela P-70202047-00576-0, nga sipërfaqja e përgjithshme 2100m² pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa me shkrim, lista poseduese e pronës dhe kopja e planit.
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

Datë 16.06.2025

Për KPF-në dhe Kuvendin e Komunës

Propozues: Kryetari i Komunës z.Ferit Idrizi

Hartues: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, z.Remzi Ahmeti

Tema: Propozim-vendim

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 19, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4, lidhur me nenin 17, paragrafi 11 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 2025 merr këtë:

V E N D I M

për miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri

1. Me këtë vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin **Bastri-Hajzer Beqiri**, në sipërfaqe prej 100 m², pjesë nga parcela P-70202047-00576-0, nga sipërfaqja e përgjithshme 2100 m² pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa me shkrim, lista poseduese e pronës dhe kopja e planit.
4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) dite pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi


Kryesuese e Kuvendit

Arsyetim


Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, duke ju përgjigjur kërkesës së Shoqatës së Familjes së Dëshmorëve Dega në Vushtri, për lejimin e caktimit të lokacionit për ndërtimin e lapidarit për dëshmorin Bastri-Hajzer Beqiri, në konsultim me kryetarin e komunës ka hartuar propozim-vendimin për caktim të lokacionit për ndërtimin e lapidarit në fjalë.

Drejtoria ka shqyrtuar dokumentacionin lidhur me këtë projekt dhe konstaton se lokacioni i ceku në propozim i plotëson kushtet për caktimin e këtij lokacioni për ngritjen e këtij lapidari.

Nga të cekurat më lartë i propozojmë Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës, që ta aprovoj këtë propozim-vendim si në dispozitiv të tij.


Remzi Ahmeti

Drejtore i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrri, Melihate Basholli - Latifi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Shendrita Latifi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 29309/25 për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, datë 26.16.2025.

I nderuar kryetar Idrizi,
E nderuar kryesuese Basholli - Latifi,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 02.07.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin Nr. 29309/25 për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë, datë 26.16.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Vushtrisë:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi Nr. 29309/25 për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit, miratuar nga Kuvendi Komunal i Vushtrisë, datë 26.16.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, të gjitha planifikimet në kuadër të komunave duhet të jenë në përputhje me Dokumentin e Planifikimit Hapësinor të miratuar nga Kuvendi i Komunës.

P.S. Sipas Certifikatës së pronës, kjo njësi kadastrale është pronë e Komunës së Vushtrisë, me llojin e shfrytëzimit bujqësor. Shfrytëzimi aktual i parcelës është kullosë, ndërsa cilësia e klasës është kullosë e klasës së tretë.

Gjithashtu, vendimi i përmendur më lart hyn në kuadër të Shtojcës II: Lista e akteve të komunës që nuk i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, sipas Rregullores së Qeverisë së Republikës Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Nga ajo që u tha më lartë, të vepohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.